



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Punëhënës/Prodator Received/Delivertory		viti god year	
07.12.2021		4	
Organ / Mjeshtja Organ / Jedinita Org./Unit	Nr. Prot. Hr. Prot. Prot. No.	Shkup / a Prilog / a Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/HCK	5850/2021		4/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A. Nr.892/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.892/2021 të datës 29.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr., „Ali Kelmendi“, Nr. 34, Ferizaj, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në çështjen administrative-juridike „kompensim material“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.892/2021 e datës 29.10.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoli 3420/21 i datës 30.08.2021, i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

**A r s y e t i m**

Ankuesi tani i pensionuar, me datë 29.10.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 3420/21 të datës 30.08.2021, të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më të cilin i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, me pretendimin ankimore që ti njihen edhe dy paga përcjellëse ashtu si është paraparë më Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.11.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Ministria e Mjedisit, Planifikimit





Hapësinor dhe Infrastrukturës (me tej MMPHI), ndërsa me datë 10.11.2021, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën A nr. 892/2021, e datës 29.10.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vendimin me numër protokolli 3420/2021 të datës 24.08.2021 të Zëvendës Sekretarit i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kërkesën e datës 8.10.2021, drejtuar Departamentit Ligjor të MMPHI nga ankuesi dëshmi e datës 01.09.2021, deri me datën 30.09.2021, lidhur me pagën e fundit për ankuesin; dëshmi e datës 01.09.2021, deri me datën 30.09.2021, lidhur me pagën e fundit lidhur me kompensimin e arritjes së moshës së pensionimit; Akt Emërimi i datës 03.06.2014, i ankuesit Përgjigjen në ankesës e datës 10.11.2021, me numër protokolli 5387/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar sepse:

Nga shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 03.06.2014 ka qenë i punësuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor tani Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Kemikate dhe Mbeturina. Me datë 25.03.2021, Zyra e Personelit ka njoftuar paraprakisht ankuesin së me datë 20.09.2021, i njëjti arrin moshën e pensionimi, duke udhëzuar mbi të drejtën e shfrytëzimit të pushimi vjetor të mbetur, ndërsa me datë 30.08.2021 Zëvendës Sekretarit i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 3420/21 të datës 30.08.2021, më të cilin ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit me datë 20.09.2021, duke i njohur të drejtën e pagës përcjellëse në shumën prej një page mujore, e të cilën pagë ankuesi e ka realizuar me datë 30.09.2021.

Ankuesi me datë 08.10.2021, i është drejtuar me kërkesë më shkrim Departamentit Ligjor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me njohjen edhe të dy pagave sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Në përgjigje të kësaj kërkesë Zyra e Personelit ka njoftuar ankuesin së bazuar në Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet tjera të Shërbyesve Civilë ankuesit i njihet vetëm e drejta e kompensimit të një pagese në vlerën e një pagë të fundit. I pakënaqur me këtë përgjigje ankuesi brenda fatit ligjor parashtron ankesë në KPMSHCK me pretendime të njëjta ankimore gjegjësisht që ti njihen edhe dy paga përcjellëse ashtu siç është paraparë më Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-



së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Andaj, mbi këtë bazë Kolegji konstaton së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit sepse ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 20.09.2021 respektivisht në kohën kur nuk është e aplikueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Bazuar në konstatimin si me lartë, Kolegji vlerëson së Zëvendësuesi i Sekretarit i Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër me numër protokolli 3420/21 të datës 30.08.2021 përmes të cilit ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit të një page përcjellëse në vlerën e pagës së fundit, ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 2 nenparagrafi 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë përkatësisht nenin 19 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.892/2021**

  
Rushit Kajtazi  
Procesmbajtës

  
Ardita Haxhnikaj-Demi  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPH ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

